

**REZYME**  
**TEMA MASTER**

“NDËRHYRJA HUMANITARE DHE SOVRANITETI - RASTET E NDËRHYRJES  
HUMANITARE NË SOMALI, SIERRA LEONE, TIMORIN LINDOR, IRAK, LIBI DHE NË  
JUGOSLLAVI”

Nga

Shqipërim Godeni



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE  
POLITIKË NDËRKOMBËTARE  
PRISHTINË

**Prishtinë**  
**Shtator, 2023**

# **“NDËRHYRJA HUMANITARE DHE SOVRANITETI - RASTET E NDËRHYRJES HUMANITARE NË SOMALI, SIERRA LEONE, TIMORIN LINDOR, IRAK, LIBI DHE NË JUGOSLLAVI”**

**Mentor:** Prof. Anton Vukpalaj

## **Qëllimi i punimit:**

Gjatë punimit të këtij hulumtimi janë bërë analiza dhe vlerësime të ndërhyrjeve humanitare të OKB-së në vende të ndryshme. Qëllimet kryesore të zgjedhjes dhe elaborimit të temës së masterit “NDËRHYRJA HUMANITARE DHE SOVRANITETI - RASTET E NDËRHYRJES HUMANITARE NË SOMALI, SIERRA LEONE, TIMORIN LINDOR, IRAK, LIBI DHE NË JUGOSLLAVI” janë:

1. Studimi i ndërhyrjeve humanitare të OKB-së në vendet që kanë pësuar nga rënia e komunizmit, duke përfshirë analizën e misionëve të ndryshme dhe efektivitetit të tyre
2. Identifikimi i sfidave dhe vështirësive të ndërhyrjeve humanitare të OKB-së në këto vende, duke përfshirë sfidat politike, sociale, ekonomike dhe të sigurisë.
3. Analiza e impaktit të ndërhyrjeve humanitare të OKB-së në këto vende, duke përfshirë analizën e rezultateve të arritura, si dhe sfidat dhe problemet që kanë qenë të pranishme.
4. Identifikimi i mënyrave për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e ndërhyrjeve humanitare të OKB-së në këto vende.

## **• Kapitulli I**

Në kapitullin e parë kam paraqitur qasjet teorike rreth ndërhyrjes humanitare në të drejtën ndërkombëtare. Si qasje teorike, është filluar me qasjen realiste dhe liberalizmi, por përveq këtyre si qasje teorike janë përdorur edhe Shkolla Angleze, Postmodernizmi, Konstruktivizmi dhe Teorike Kritike. Në këtë pjesë kam paraqitur rëndësinë që kanë koncepte të tilla si sovraniteti dhe të drejtat e njeriut për këto qasje teorike dhe si i interpretojnë ato këto koncepte. Kjo pasqyrohet në pjesën ku janë paraqitur autorët e secilës qasje teorike.

- **Kapitulli II**

Këtë kapitull e përbën shqyrtimi i ndërhyrjeve si në Somali, Timori Lindor, Sierra Leone, Libia dhe Iraku si tërësi por dhe çdo rast në veçori , preceptimet dhe argumentet e ndryshme të autorëve të së drejtës ndërkombëtare rreth tyre, shqyrtimi i tyre nga këndvështrimi i secilës nga qasjet e përmendura teorike dhe analizimi i efikasitetit dhe efektivitet të këtyre ndërhyrjeve. Duke qenë se shtjellimi i tyre përbën kapitullin e dytë janë paraqitur edhe veçoritë dhe ngjajshmëritë ndërmjet këtyre rasteve si dhe janë paraqitur rekomandimet se si do të mund të zgjidheshin këto raste.

- **Kapitulli III**

Kapitulli i tretë përmban ndërhyrjet humanitare që kanë ndodhur në Europë, rastin e Bosnjës dhe të Kroacisë. Ky kapitull për hyrje ka shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, procesin dhe arsyet e shpërbërjes, rolin e Europës dhe të komunitetit ndërkombëtar. Pastaj, vazhdon me rastin e Bosnjës. Në rastin e Bosnjës do të shohim pafuqinë e Europës për t'iu përgjigjur rasteve të tilla por edhe hezitimin e bashkësisë ndërkombëtare në përgjithësi për të ndërhyrë në Bosnjë dhe njëkohësisht do të kuptojmë pse Bosnja vazhdon të shihet si dështim i së drejtës ndërkombëtare dhe të komunitetit ndërkombëtarë në përgjithësi. Kapitulli vazhdon me rastin e Kroacisë, reagimin ndërkombëtar, një paraqitje të ndërhyrjes ndërkombëtare në Kroaci, përkatësisht me shtjellimin e misioneve të OKB-ës në Kroaci.

- **Kapitulli IV**

Kapitulli i katërt fillon me rastin e Kosovës. Në këtë kapitull janë paraqitur të gjitha ngjarjet që i kanë paraprirë intervenimit të NATO-s në Kosovë dhe ngjarjet pas tij. Më konkretisht, ky kapitull përfshinë, reagimin ndërkombëtar ndaj krizës në Kosovë; negociatat e Christopher Hill për zgjidhjen e situatës në Kosovë; misionin e OSBE-së; marrëveshjen Holbrook-Miloshevic; konferencën e Rambujes dhe intervenimi i NATO-s; rezoluta 1244 dhe administrimi ndërkombëtar i Kosovës dhe, në fund, negociatat e Vjenës dhe Pakoja e Ahtisarit. Rasti i luftës në Kosovë përbën kapitullin e katërt dhe të fundit të këtij punimi. Shtjellimi i këtij rasti është bërë pothuajse në të gjitha fazat e zhvillimit, duke filluar që nga fillimi i krizës në Kosovë, reagimi ndërkombëtarë ndaj kësaj krize, negociatat për zgjidhjen e krizës që njihen si negociatat e Christophet Hill-it,

misionin e OSBE-së, marrëveshjen Holbrooke – Milosheviç, konferencën e Rambujes që solli më pastaj intervenimin e NATO-s, rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtarë. Pjesa e fundit e këtij kapitulli përmbyllës përbëhet nga shtjellimi i negociatave të Vjenës që i japën fund administrimit ndërkombëtarë të Kosovës dhe Pakos së Ahtisarit që ishte produkt i këtyre negociatave. Gjatë krahasimit me rastin e Bosnjës dhe të Kroacisë, do të shohim se procedurat burokratike të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e vështirësuan ndërhyrjen, ndërsa në rastin e Kosovës, këto procedura do të shmangen duke i dhënë rëndësi të drejtës humanitare.

- Pjesa përmbyllëse e gjithë këtij punimi përmban konkluzionin dhe në fund përmbyllet me bibliografinë.